



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2021/4 prot.

Datë 29.08.2023

V E N D I M

Nr. 833 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.08.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur e Thjeshtuar*” shërbime, me nr. REF-69120-05-11-2023, me objekt “*Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*” me fond limit 6.000.000 lek pa TVSH, **Loti I:** REF-69122-05-11-2023, me objekt “*Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*” (për *landfillin*), me fond limit 3.000.000 lek pa TVSH, zhvilluar me datë 04.08.2023 nga autoriteti kontraktor, ECO-ELB Sh.A.

Ankimues: “Tenius Laboratories” SHPK
Adresa: Rruga dytësore Maminas-Vorë, Nr. 20/38, Koxhas, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: ECO-ELB Sh.A
Adresa: Lagjja “Brigada 17 Sulmuese”, bulevardi “Qemal Stafa” Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin*”

e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.05.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur e Thjeshtuar*” shërbime, me nr. REF-69120-05-11-2023, me objekt “*Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*”, me fond limit 6.000.000 lek pa TVSH, **Loti I:** REF-69122-05-11-2023, me objekt “*Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*” (për landfillin), me fond limit 3.000.000 lek pa TVSH, zhvilluar me datë 04.08.2023 nga autoriteti kontraktor ECO-ELB SHA.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 04.08.2023 është zhvilluar procedura prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Autoriteti kontraktor më datë 16.08.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave dhe klasifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

1. Tenuis Laboratories ShPK	1.600.000 L pa TVSh	skualifikuar
2. ECCAT Environmental consulting, Chemical Analysis & Testing ShPK	1.806.000 L pa TVSh	skualifikuar
3. Eko-Studio-Projekt ShPK	2.097.000 L pa TVSh	kualifikuar
4. BOE Go-Green Studio ShPK dhe ALPHA STUDIO ShPK	2.750.000 L pa TVSh	skualifikuar

II.4. Më datë 17.08.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Tenuis Laboratories” SHPK ka depozituar ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me numër ankimi elektronik A/2023/3367 me datë 18.08.2023 dhe me nr. 2021/2023 prot., datë 21.08.2023, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari për publikim me Nr. 2021/2 Prot., datë 22.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “TENUIS” nuk përmbush kriterin 2.3.4 te DST .

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- *Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.*
- *Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.*

OE nuk ka paraqitur Certifikatën e kontrollit teknik për mjetin AA 236 IT.

Operatori ekonomik “TENUIS” nuk përmbush kriterin 2.3.11 e DST .

2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Laboratori nuk është i Akredituar sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Oferta e Operatori ekonomik “TENUIS” ka paraqitur oferte anomalisht te ulet perllogaritur sipas Pikes 22 te DST “Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta.”

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në

njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatori ekonomik "TENUIS" ShPK nuk kualifikohet."

II.7. Me shkresën nr. 520 prot, datë 24.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2021/3, datë 25.08.2023 me objekt: "Informacion" nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e paraqitur në procedurën e prokurimit sipër cituar, nga informacioni i përcjellë vërehet se KSHA ka marrë në shqyrtim ankesën dhe ka vendosur mospranimin e pretendimeve të ankimesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në datën 12.05.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit "E hapur e Thjeshtuar" shërbime, me nr. REF-69120-05-11-2023, me objekt "Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore" me fond limit 6.000.000 lek pa TVSH, **Loti I:** REF-69122-05-11-2023, me objekt "Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore" (për landfillin) , me fond limit 3.000.000 lek pa TVSH, zhvilluar me datë 04.08.2023 nga autoriteti kontraktor ECO-ELB SHA.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton, se me datë 04.08.2023 është zhvilluar procedura prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3 Autoriteti kontraktor më datë 16.08.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave dhe klasifikimin e operatorëve ekonomikë ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

1. Tenuis Laboratories ShPK	1.600.000 L. pa TVSh	skualifikuar
2. ECCAT Environmental consulting, Chemical Analysis & Testing ShPK	1.806.000 L pa TVSh	skualifikuar
3. Eko-Studio-Projekt ShPK	2.097.000 L pa TVSh	kualifikuar
4. BOE Go-Green Studio ShPK dhe ALPHA STUDIO ShPK	2.750.000 L pa TVSh	skualifikuar

III.1.4. Më datë 17.08.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit.

III.1.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik "Tenius Laboratories" SHPK ka depozituar ankesë nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me numër ankimi elektronik A/2023/3367 me datë 18.08.2023 dhe me nr.

2021/2023 prot., datë 21.08.2023, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari për publikimi me Nr. 2021/2 Prot., date 22.08.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik “TENUIS” nuk permbush kriterin 2.3.4 te DST .

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.*
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.*

OE nuk ka paraqitur Certifikatën e kontrollit teknik për mjetin AA 236 IT.

Operatori ekonomik “TENUIS” nuk permbush kriterin 2.3.11 e DST .

2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Laboratori nuk është i Akredituar sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Oferta e Operatori ekonomik “TENUIS” ka paraqitur oferte anomalisht te ulet perllogaritur sipas Pikes 22 te DST “Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta”

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatori ekonomik “TENUIS” ShPK nuk kualifikohet.”

III.1.7. Me shkresën nr. 520 prot, datë 24.08.2023, protokolluar me tonën me nr. 2021/3, datë 25.08.2023 me objekt: “Informacion” nga autoriteti kontraktor në lidhje me ankesën e paraqitur në procedurën e prokurimit sipërcituar, nga informacioni i përcjellë vërehet se KSHA ka marrë në shqyrtim ankesën dhe ka vendosur mospranimin e pretendimeve të ankimuesit.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se : *Operatori ekonomik “TENUIS” nuk përmbush kriterin 2.3.4 të DST .*

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- *Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.*
- *Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.*

OE nuk ka paraqitur Certifikatën e kontrollit teknik për mjetin AA 236 IT.

III.2.1. Referuar dokumenteve të tenderit: Shtojca 8, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.4, Autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcat si edhe ka modifikuar kriterin si vijon:
Ishte

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete, për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

Bëhet

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

III.2.2. Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST shtojcën 9,

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarimene vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t’u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p>
<p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministtrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.- Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).</p> <p>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.</p>
<p>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".</p> <p>Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.</p>

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</p>

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ _____ <u>Profili i punonjësve</u> _____ _____ <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:

Emri, Mbiemri _____
Firma _____
Vula _____
Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraparak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.2.3. Referuar dokumentacionit ngarkuar në SPE nga OE “Tenius Laboratories” SHPK rezulton, se në përmbushje të kriterit 2.3.4 sipër cituar, operatori ka ngarkuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ku deklaron në:

Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), OE ka plotësuar: *se ka mjete dhe makineritë për realizimin e kontratës*, PO [x]

Gjithashtu bashkëlidhur dokumentacionit të ofertës, operatori ankimues ka hedhur në SPE disa dokumente plotësuese në përmbushje të pikës 2.3.4.

1. Dokument nga e-Albania mbi automjetin në zotërim marka VOLKSWAGEN CADDY, Targa AA2361T.
2. Policë për sigurimin e detyrueshëm për mjetin VOLKSWAGEN CADDY, Targa AA2361T.
3. Leje qarkullimi për mjetin VOLKSWAGEN CADDY, Targa AA2361T.
4. Kontratë huapërdorje për automjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.

5. Policë për sigurimin e detyrueshëm për mjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.
6. Leje qarkullimi për mjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.
7. Certifikatë e kontrollit teknik për mjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.

III.2.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t’i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.2.6. Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve I të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.8. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.[....]”

III.2.9. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “**Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.4 të modifikuar ku citohet se:

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

Operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE),

1. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas (shtojca 9), Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), OE ka plotësuar: *se ka mjete dhe makineritë për realizimin e kontratës*, PO [x]

Referuar kërkesës “Nëse po, të listohen me të dhëna konkrete” OE nuk ka listuar apo evidentuar numrin e makinerive, markën, tonazhin, targat si të dhëna minimale për të vërtetuar deklaratën e tij mbi disponim të mjeteve.

2. Dokument nga e-Albania mbi automjetin në zotërim marka VOLKSWAGEN CADDY, Targa AA2361T.
3. Policë për sigurimin e detyrueshëm për mjetin VOLKSWAGEN CADDY, Targa AA2361T.
4. Leje qarkullimi për mjetin VOLKSWAGEN CADDY, Targa AA2361T.
5. Kontratë huapërdorje për automjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.
6. Policë për sigurimin e detyrueshëm për mjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.
7. Leje qarkullimi për mjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.
8. Certifikatë e kontrollit teknik për mjetin Autoveturë, marka SKODA. Targa AA359XD.

Autoriteti kontraktor ka skualifikuar këtë operator ekonomik me arsyetimin se *OE Operatori ekonomik “TENUIS” nuk përmbush kriterin 2.3.4 të DST.*

2.3.4 Operatori Ekonomik, duhet të disponojë të paktën 2 (dy) mjete në pronësi ose me qira për të bërë të mundur lëvizjen e instrumenteve dhe pajisjeve laboratorike, për realizimin e projektit.

- Për mjetet që janë në pronësi duhet të paraqiten dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit leja e qarkullimit: certifikatën e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit i vlefshëm.
- Për mjetet që janë me qira krahas dokumentit të mësipërm duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë.

OE nuk ka paraqitur Certifikatën e kontrollit teknik për mjetin AA 236 IT.

Komisini vëren, se operatori ekonomik ofertues është subjekti më i interesuar në plotësimin e dokumenteve të tenderit me saktësi dhe përpikëri, më qëllim që oferta e tij të rezultojë e vlefshme. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Ligjvënësi me qëllimin për të lehtësuar punën e operatorëve ekonomikë në përgatitjen në kohë të ofertave, ka përcaktuar se, në fazën e vlerësimit të ofertave operatorët ekonomikë mund të plotësojnë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në vend të paraqitjes së disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta.

Në rastin konkret nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjes administrative dhe verifikimeve të kryera rezulton, se operatori ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK nuk ka

plotësuar me informacionin e kërkuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, duke mos dhënë informacion të plotë në përmbushje të kriterit 2.3.4. e konkretisht nuk ka listuar apo evidentuar numrin e makinerive, tonazhin, markën, targat, si të dhëna minimale për të vërtetuar deklaratën e tij, në përmbushje të kërkesës në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas (shtojca 9), Pjesa III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme, “Nëse po, të listohen me të dhëna konkrete”, mbi disponim të mjeteve të nevojshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar.

III.2.10. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i pavlefshëm për këtë fazë. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, është në përputhje me kriterin e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor për plotësimin e këtij kapaciteti, pasi nga shqyrtimi dokumentacionit të ofertës së ankimuesit rezulton, se operatori ekonomik nuk ka plotësuar kriterin kualifikues 2.3.4.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit në këtë fazë, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i pavlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Tenuis Laboratories” SHPK nuk qëndron

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Tenuis Laboratories” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi me arsyetimin se : *Operatori ekonomik “TENUIS” nuk përmbush kriterin 2.3.11 e DST.*

2.3.11 Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Laboratori nuk është i Akredituar sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

[...theksojme se objekt prokurimi është Monitorimi mjedisor dhe jo analizimi i mbetjeve që asgjeshohen landfill ose impiant. Ky është një kriter që bie në kundërshtim me objektin prokurimit. Laboratori Tenuis është një laborator akredituar nga DPA (sipas Certifikates së Akreditimit) për analizë Mbetje, llumrat, dhe terrene (te ngjashme) ku përfaqësohen të gjitha llojet e mbetjeve dhe për rrjedhojë ky argument nuk qëndron.]

III.3.1. Referuar dokumenteve të tenderit: Shtojca 8, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.11, Autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.11.Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

III.3.2. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqet e parashtruara

në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3367 me datë 18.08.2023 dhe me nr. 2021/2023 prot., datë 21.08.2023, paraqitur nga operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK, ka lidhje me vendimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji”. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.3.3. Marrë shkas nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se kriteri 2.3.11 është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton kufizim e cënon konkurrencën, duke kufizuar pjesëmarrjen e ofertuesve në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor, konkretisht KPP vëren se:

Në Shtojcën 8, Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3.11, Autoriteti kontraktor ka kërkuar:

2.3.11.Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve urbane si, letra, karton etj.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.3.4 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

-Certifikatë Akreditimi me Nr. Regjistri LT122
Akredituar për kryerjen e testeve në përputhje me S SH ISO/TEC 17025:2017
Datë akordimi të akreditimit: 12.05.2023
Me datë vlefshmërie deri më 11.05.2027.

III.3.5 Në DST autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë: Shtojcat 5,6,8
Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Specifikimet teknike në lidhje me Landfillin.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Objektivat e këtij vlerësimi janë:

- të pasqyrojë emisionet e lëngeta, cilësinë e tyre dhe ndikimin e tyre në ujrat pritëse;*
- të pasqyrojë nivelin e grimcave të ngurta pezull në ajër;*
- të pasqyrojë nivelin e zhurmës së aktivitetit dh edikimit në popullatën lokale;*
- të pasqyrojë nivelin e gaeve të emetuar në ajër;*
- të kryjë një vëzhgim të përgjithshëm mbi ndotjen dhe ndikimet evidente në mjedisin përreth zones së aktivitetit;*
- të nxjerrë rezultate në lidhje me performancën e përgjithshme mjedisore të aktivitetit;*
- të japë rekomandime për përmirësime të mundshme teknologjike dhe menaxhimi që mund të sjellin ulje të ndikimit në mjedis.*

2. Në tabelën e mëposhtme paraqiten të gjitha të dhënat mbi programin e monitorimit në landfill-in e Elbasanit:

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i shkarkimit apo mjedisit që monitorohet</i>	<i>Parametri mjedisor që monitorohet</i>	<i>Vendi/pozicioni/Pika e monitorimit (matjes apo mostrimit/kampionimit)</i>
------------	---	--	--

1	Uje (moster e ujrave siperfaqesore)	<p>1.pH 2.Temperature 3.DO 4.BOD5 5. COD 6.N-NH4 7. Rrjedhia ditore 8.Rrjedhia maksimale 9.P-total</p>	<p>3 mostra</p> <p>1.Ne rrjedhen e sipërme të lumit Shkumbin (20 cm thellësi) X: 4420832.50 Y: 4550506.08</p> <p>2.Ne rrjedhen e poshtme të lumit Shkumbin (20 cm thellësi) X: 4420273.51 Y: 4550235.25</p> <p>3.Uje i shesheve të impiantit X: 4421104.63 Y: 4550727.88</p>
2	Uje (Shkarkimet në kanalizime)	<p>1.pH 2.Temperature 3.DO 4.BOD5 5. COD 6.N-NH4 7. Rrjedhia ditore 8.Rrjedhia maksimale 9.P-total 10.Lende pezull 11..N-Total</p>	<p>1 moster</p> <p>X: 4421104.630 Y: 4550727.888</p>
3	Uje (moster ujore nëntokësore të pusëve piezometrik)	<p>1.pH 2.Turbiditeti 3.Lendet pezull 4.Konduktiviteti elektrik 5.Oksigjen i tretur 6.BOD5 7.COD 8.N-NO3 9.N-total 10.P-total 12.Cl- 13.Arseniku 14.Bakri 15.Plumbi 16.Nikeli 17.Kromi VI 18. Zinku 19.Hekur 20.Koliform total</p>	<p>4 mostra</p> <p>Piezometri 1 X: 4420464.94 Y: 4550553.74</p> <p>Piezometri 2 X: 4420528.51 Y: 4550431.47</p> <p>Piezometri 3 X: 4420366.83 Y: 4550375.61</p> <p>Piezometri 4 X: 4420328.38 Y: 4550502.35</p>
4	Ajer	<p>1.Grimca të ngurta në ajër (LNP mes & LNPmax & PM10) 2. Gaze</p> <ul style="list-style-type: none"> • CO • NO2 • SO2 • CXHY 	<p>4 pika</p> <p>Pika 1 Impianti i trajtimit të leksivateve X: 4421104.63 Y: 4550727.88</p> <p>Pika 2 Në juglindje të landfill-it X: 4420511.88 Y: 4550434.88</p> <p>Pika 3 Në verilindje të landfill-it X: 4420464.47 Y: 4550549.40</p> <p>Pika 4 Në hyrje të landfill-it X: 4420370.91 Y: 4550376.29</p>

5	Çlirimi I zhurmës në mjedis (ndotja akustike)	1. Niveli i zhurmës për parametrat <ul style="list-style-type: none"> ▪ LAeq ▪ LAmax 	4 pika Pika 1 Në verilindje të landfill-it X: 4420464.47 Y: 4550549.40 Pika 2 Në juglindje të landfill-it X: 4420511.88 Y: 4550434.88 Pika 3 Në jugperendim të landfill-it X: 4420370.91 Y: 4550376.29 Pika 4 Impianti i trajtimit të lëksivateve X: 4421104.63 Y: 4550727.88
---	---	--	---

RAPORTIMET Sipas urdherit nr.77

Bazuar në Urdhrin me Nr 77 datë 02.07.2020 Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit, **dokumentat për Zbatimin e Kushteve Vjetore**

Nr.	Kushti i lejes Mjedisore	Emertimi i Dokumentit
1	2	Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e përberësve të mjedisit për instalimin/impiancin
2	2.9.2	Programi i menaxhimit të mjedisit
3	2.9.2	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotjes – Raporti për vitin paraardhës
4	2.9.2	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotjes – Propozim për vitin aktual
5	2.9.2	Raport përmbledhës mbi rezultatet e monitorimit të zhurmës
6	2.9.2	Përshkrimi i monitorimit të mjedisit
7	2.9.2	Përshkrimi i Incidenteve/Aksidenteve
8	2.9.2	Raport përmbledhës për Auditimin e Eficencës së Energjisë
9	2.9.2	Raport për vlerësimin e efikasitetit të shfrytëzimit të lëndëve të para dhe reduktimin e gjenerimit të mbetjeve
10	2.9.2	Menaxhimi i mbetjeve
11	2.9.2	Raport Përmbledhës për Auditimin e Eficencës së Ujit
12	2.9.2	Deklaratë mbi masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit
13	2.9.2	Programi i Menaxhimit të Riskut
14	2.9.2	Plan i Perputhshmërisë
15	2.9.2	Plani i Cmëntimit ose rehabilitimit
16	10	Lendet e para dhe shfrytëzimi I energjisë
17	12	Dokumentimi dhe Raportimi
18		Raport mbi ankesat
19	13	Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave
20	14	Cmëntimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve
21		Raporti Vjetor i Monitorimit

Bazuar në Urdhrin me Nr 77 datë 02.07.2020 Për procedurën e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit, **dokumentat për Zbatimin e Kushteve 3 Mujore**

Kushti i lejes Mjedisore	Zbatimi i kushteve periodike 3 mujore
1.6	Vendndodhja e ushtrimit të veprimtarisë
6	Njoftimet
7	Shkarkimet
7	Plani i menaxhimit të tretësavë organike

7	<i>Inspektime Vizuale Ditore/Javore/Mujore per instalimet dhe shkarkimet ne ajer, uje, toke, zhurme, mbetje.</i>
7	<i>Mirembajtja/Plani i Sherbimeve</i>
8	<i>Menaxhimi i mbetjeve</i>
8	<i>Plani i Menaxhimit te mbetjeve</i>
9	<i>Zhurmat dhe Vibracionet</i>
11	<i>Monitorimi</i>
12	<i>Dokumentimi dhe Raportimi</i>
12	<i>Raporti Periodik i Monitorimit</i>

Specifikimet teknike në lidhje me impiantin.

Parametrat e ujit qe do te analizohen.

<u>Nr.</u>	<u>Parametri</u>	<u>Vendi I mostrimit</u>
<u>1</u>	<i>pH</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime, Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>2</u>	<i>Rrjedhja ditore m³, Niveli max i rrjedhjes m³/ore</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime, Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>3</u>	<i>Temperatura</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>4</u>	<i>Lëndët në pezulli</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>5</u>	<i>Nevoja biokimike për oksigjen, (BOD5)</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>6</u>	<i>Nevoja kimike per oksigjen, COD</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>7</u>	<i>Nitrati total (N-NO₃-)</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>8</u>	<i>Nitrat Amoni</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>9</u>	<i>Fenolet volatile</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>10</u>	<i>Benzeni</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>11</u>	<i>Toksiciteti</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>12</u>	<i>Oksigjeni i tretur, DO</i>	<i>Shkarkim kanalizime</i>
<u>13</u>	<i>Përbërësit organikë të fosforit (P-org)</i>	<i>Shkarkim kanalizime</i>
<u>14</u>	<i>Percjellshmeria elektrike</i>	<i>Shkarkim ne ujera siperfaqesore</i>
<u>15</u>	<i>Azot amoniaku N</i>	<i>Shkarkim ne kanalizime</i>

Parametrat e ajrit qe do te analizohen.

<u>Nr.</u>	<u>Parametri</u>	<u>Vendi I mostrimit</u>
	<i>SO₂</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>NO₂</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>NO_x</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>O₂</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>CO</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>C_xH_x</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>Lenda e ngurte totale</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>HCL</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>HF</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>TM(Sb+As+Pb+Cr+Co+Cu+Mn+Ni+V)</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>Cd & TL</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>Hg</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>PCDD/PCDF</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>Temperatura, Presioni</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>SHpejtësia</i>	<i>Oxhaku I inceneratorit</i>
	<i>Grimca</i>	<i>Ajri I ambientit</i>
	<i>PM₁₀</i>	<i>Ajri I ambientit</i>
	<i>Zhurmat ne ambient</i>	<i>Ne 8 pika (sipas percaktimeve ne lejen mjedisore)</i>

Monitorimi I parametrave mjedisore për impiantin do të bëhet sipas kushteve të përcaktuara të lejes mjedisore , tipi A me PN-5783-09-2017.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Afatet e ekzekutimit:

Monitorimi dhe hartimi i raporteve periodike dhe vjetore bazuar në Urdhërin nr. 77, datë 02.07.2020 "Për procedurat e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit" për landfillin

Afatet e ekzekutimit:

Lloji i shkarkimit apo mjedisit që monitorohet	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Ujë (moster e ujrave sipërafaqësore)	Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit	- 1 – 7 Qeshor - 1 – 7 Shtator - 1 – 7 Dhjetor - 1 – 7 Mars
Ujë (shkarkimet në kanlizime)	Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit	- 1 – 7 Qeshor - 1 – 7 Shtator - 1 – 7 Dhjetor - 1 – 7 Mars
Ujë (moster ujore nëntokësore të puseve piezometrik)	Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit	- 1 – 7 Qeshor - 1 – 7 Shtator - 1 – 7 Dhjetor - 1 – 7 Mars
Ajër	Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit	- 1 – 7 Qeshor - 1 – 7 Shtator - 1 – 7 Dhjetor - 1 – 7 Mars
Çlirimi i zhurmës në mjedis (ndotja akustike)	Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit	- 1 – 7 Qeshor - 1 – 7 Shtator - 1 – 7 Dhjetor - 1 – 7 Mars

Monitorimi dhe hartimi i raporteve periodike dhe vjetore bazuar në Urdhërin nr. 77, datë 02.07.2020 "Për procedurat e dorëzimit/pranimit të dokumentave dhe raporteve të vetëmonitorimit" për Impiantin

Lloji i shkarkimit apo mjedisit që monitorohet	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
<i>Ujë (moster e ujrave sipërafqësore)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	- 1 – 7 Gusht - 1 – 7 Nëntor - 1 – 7 Shkurt - 1 – 7 Maj
<i>Ujë (shkarkimet në kanlizime)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	- 1 – 7 Gusht - 1 – 7 Nëntor - 1 – 7 Shkurt - 1 – 7 Maj
<i>Ajër</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	- 1 – 7 Gusht - 1 – 7 Nëntor - 1 – 7 Shkurt - 1 – 7 Maj
<i>Çlirimi i zhurmës në mjedis (ndotja akustike)</i>	<i>Vendgrumbullimi i mbetjeve të Elbasanit</i>	- 1 – 7 Gusht - 1 – 7 Nëntor - 1 – 7 Shkurt - 1 – 7 Maj

Hartimi I Raporteve vjetore	
<i>Për landfillin</i>	<i>Afati I ekzekutimit deri në datën 7 Dhjetor</i>
<i>Për impiantin</i>	<i>Afati I ekzekutimit deri në 22 Gusht</i>

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

1. *Qellimi i këtij raporti monitorimi është të pasqyrojë situatën reale të performancës mjedisore të landfill-it të Elbasanit dhe të paraqesë ndikimet që ky objekt kanë mjedis përreth në përputhje me kërkesat ligjore. Është e rëndësishme që të dhënat e prodhuara të jenë përfaqësuese, të domosdoshme, të vlefshme dhe që lejojnë vlerësimin e saktë të ndikimit të deponisë në mjediset. Qellimi i programit të monitorimit fillimisht duhet të identifikohet nga procesi i hetimit, vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe natyra e mbetjeve që depozitohen. Ai duhet të përfshijë të gjitha fushat mjedisore që mund të ndikohen ndjeshëm përmes funksionimit të landfillit.*
Monitorimi i ujit sipërfaqësor dhe nëntokësorë duke përfshirë bio-cilësinë dhe analizimin e parametrave kryesore.
Monitorimi i ajrit dhe shqyrtimi i niveleve të ndotjes në zonë duke identifikuar parametrat që janë në nivele problemetike.
Monitorimi i ndotjes akustike ka për qëllim vlerësimin e nivelit të ndotjes akustike në pikat kryesore të zonës, për të dhënë mundësinë që të gjykohe mbi nivelin e zhurmës së emtuar.
2. *Ai duhet të përfshijë të gjitha fushat mjedisore që mund të ndikohen ndjeshëm përmes funksionimit të impiantit*
Monitorimi i ujit sipërfaqësor dhe nëntokësorë duke përfshirë bio-cilësinë dhe analizimin e parametrave kryesore.

Monitorimi i ajrit dhe shqyrtimi i niveleve të ndotjës në zonë duke identifikuar parametrat që janë në nivele problemetike.

Monitorimi i ndotjes akustike ka për qëllim vlerësimin e nivelit të ndotjes akustike në pikat kryesore të zonës, për të dhënë mundësinë që të gjykohe mbi nivelin e zhurmës së emetuar

Shtojca 8

Loti I: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (per landfillin)

Loti II: “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore”(për impiantin)

III.3.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht, se “Qëllim i këtij ligji” është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.7 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.3.8. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin

operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit. 41 4. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë. 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë. b) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi. c) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës. ç) operatori ekonomik të paraqesë ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. 7. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përllogaritur.

III.3.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorëve ekonomikë për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të objektit të kontratës dhe vullmit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me

këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti/shërbimi i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Tenuis Laboratories” SHPK ka të bëjë përkatësisht me pretendime për përmbushjen nga e tij të kriterëve për kualifikim, por në rastin e skualifikimit për kriterin 2.3.11. ankimuesi pretendon se: *[...theksojme se objekt prokurimi eshte Monitorimi mjedisor dhe jo analizimi i mbejteve qe asgjesohen landfill ose impiant.Ky eshte nje kriter qe bie ne kundërshtim me objektin e prokurimit. Laboratori Tenuis eshte nje laborator akredituar nga DPA (sipas Certifikates se Akreditimit) per analize Mbetje, llumrat, dhe terrene (te ngjashme) ku perfshihen te gjitha llojet e mbejteve dhe per rrjedhoje ky argument nuk qendron.]*

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, lidhur me hartimin e kriterëve, në çdo rast duhet të ketë parasysh elemente të tilla si proporcionaliteti me objektin e kontratës, dobishmëria dhe nevoja që ndikon në vendosjen e kërkesës. Në rastin konkret KPP vëren kërkesat në pikën 2.3.11. *Operatori Ekonomik, duhet të ketë laborator të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, sipas ISO/IEC 17025, për realizimin e matjeve të parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbejteve urbane si, letra, karton etj. Kërkesa mbi matjen e parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbejteve urbane si, letra, karton nuk është në proporcion me objektin e prokurimit, nuk është në përputhje me specifikimet teknike, nuk*

shërben për arritjen e synimit të kërkuar. Duke iu referuar objektit të prokurimit, kërkesa referuar pikës 2.3.11 shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar termave të shërbimit dhe specifikimeve teknike, në kërkesat e mësipërme nuk është kërkuar matja e parametrave dhe mbetjeve urbane, specifikisht letra karton. Akoma më tej, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterit për matjen e parametrave të ndryshëm të përbërësve të mbetjeve si letra, karton, nuk ka specifikuar elementet për të cilat do testohen në letër karton etj., gjë që krijon konfuzion për përmbushjen e këtij kriteri ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

KPP gjykon, se synimi bazë i kërkesës së autoritetit kontraktor për këtë procedurë prokurimi është kryerja e shërbimit të *Monitorimit të parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore*. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në vendosjen e kriterit objekt-ankimi, ka kufizuar numrin e pjesëmarrësve, duke ulur konkurrencën dhe duke sjellë pabarazi në rrethin e ofertuesve të interesuar për këtë procedurë prokurimi. Në rastin konkret, KPP vlerëson, se kriteri i mësipërm ka shkelur një ndër parimet e mësipërme, atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht *sine qua non* i realizimit të objektit dhe qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë të trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të kriterëve të dokumenteve të prokurimit objekt-ankimi, duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, nenin 2 dhe nenin 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se kriteri sa më sipër hartuar nga autoriteti kontraktor, ka shkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertuesve dhe njëherazi ka vështirësuar punën e KVO-së, duke qenë të kushtëzuar të bëjnë vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

III.3.11.Referuar sa më sipër KPP vëren, se kriteri i vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, për pikën 2.3.11 është kriter përjashtues, krijon konfuzion për operatorët ekonomikë të interesuar pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. Kriteret duhet të jenë të qarta dhe të sakta në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vlerësuar mbi kriterë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi, duke hartuar një kriter të saktë dhe të qartë në përputhje me parashikimet ligjore.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi

me arsyetimin se: *Oferta e Operatori ekonomik "TENUIS" ka paraqitur oferte anomalisht te ulet per llogaritur sipas Pikes 22 te DST "Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta"*

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Sa me sipër, operatori ekonomik "TENUIS" ShPK nuk kualifikohet."

[....Kur subjekti ka paraqitur nje oferte anomalisht te ulet, ne baze te ligjit Nr 162/2020 te LPP, AK i kerkon sqarime OE per oferten dhe se si OE ka dal ne kete oferte. Ne faqen e APP ne folderin Kerkesat e AK, me poste ne subjektin tone ose me email nuk na ka ardhur nje njoftim i tille ku te kerkohen sqarime per kete oferte...]

III.4.1. Autoriteti Kontraktor me vendimin e KSHA-së argumenton: *[.. në përgjigje të ankesës është e vërtetë që AK nuk ka bërë kërkesë për faktin se OE nuk plotëson disa kritere të veçanta për kualifikim çka sjell edhe paraqitje të ofertës anomalisht të ulët. Fakti që OE nuk është i akredituar dhe nuk disponon mjete të nevojshme të kërkuara nga AK...sjell kosto të ulta dhe paraqitje të ofertës së ulët çka është jashtë logjikës ekonomike....]*

III.4.2. Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën."

III.4.3. Në nenin 93 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" përcaktohet se:

"1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj [...]”

III.4.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.4.5. Referuar dokumentacionit të dosjes, arsyeve të skualifikimit, pohimeve të AK gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioni vëren, se në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, dhe konkretisht në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, është detyrë e KVO-së së autoritetit kontraktor, që të verifikojë nëse ofertat e vlefshme (të konsideruara të tilla nga vlerësimi i vetë KVO), duhet të plotësojnë kriteret për kualifikim, e më pas të vlerësohen nëse janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Kur vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët bazuar në nenin 93 pika 1 të LPP-së., i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune, shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat në përmbushje të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, dhe ndër ofertat e skualifikuara është edhe operatori ekonomik ankimues “Tenius Laboratories” SHPK, i cili rezultoi i skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve 2.3.4 dhe 2.3.11. Komisioni gjykon, se referuar nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për sa kohë oferta e ankimuesit është e skualifikuar për mospërmbushje të kriterëve për kualifikim, Autoriteti Kontraktor nuk vijon me shqyrtimin e anës ekonomike të ofertës së operatorit ekonomik të skualifikuar.

Për sa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Tenius Laboratories” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e Thjeshtuar” shërbime, me nr. REF-69120-05-11-2023, me objekt “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” me fond limit 6.000.000 lek pa TVSH, **Loti I:** REF-69122-05-11-2023, me objekt “Monitorimi i parametrave mjedisore dhe hartimi i raporteve mjedisore” (për landfillin) , me fond limit 3.000.000 lek pa TVSH, zhvilluar me datë 04.08.2023 nga autoriteti kontraktor ECO-ELB SHA.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “Tenius Laboratories” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

